

Programet aktuale të **Termonergjetikës dhe Energjisë së ripërtritshme** janë hartuar duke u mbështetur në përvojën e gjatë akademike dhe profesionale që ekziston në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe bazuar në praktikat më të mira të Universiteteve rajonale dhe Evropiane.



Programet janë të akredituara dhe përbëhen nga lëndët obligative dhe zgjedhore, me numër të caktuar të ECTS kredive.

Inxhinierët e **Termonergjetikës dhe Energjisë së ripërtritshme** mund të ushtrojnë veprimtarinë e vet profesionale në:

- *Termoelektrocentrale,*
- *Ngrohtore,*
- *Fabrika për prodhimin e pajisjeve energjetike (kaldaja, këmbyes të nxehtësisë, enë nën shtypje, etj.),*
- *Ndërmarrje për projektimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ngrohjes, ftohjes dhe klimatizimit,*
- *Ndërmarrje për projektimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të termofikimit,*
- *Ndërmarrje për projektimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve për shfrytëzimin e burimeve të ripërtritshme të energjisë.*

Lidhur me informatet tjera që kanë të bëjnë me Programin e **Termonergjetikës dhe Energjisë së ripërtritshme**, procesin mësimor, lëndët që ofrohen, përmbytjen e lëndëve në të gjitha nivelet, e të ngjashme, ju lutem na vizitoni në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, ndërtesa e Fakultetit Teknik në Prishtinë përkatësisht na kontaktoni në **Tel. 038-552126**, ose në <http://fim.uni-pr.edu>.



Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I INXHINIERISË  
MEKANIKE

Programi:

**TERMOENERGJETIKË DHE  
ENERGJI E RIPËRTRITSHME**



Me inxhinierë të rinj  
drejt qëndrueshmërisë  
energjetike të Kosovës

## Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike mbush 55 vite pune dhe aktiviteti në aftësimin e kuadrove të reja nga lëmitë makinerike, në hulumtimet fundamentale dhe të aplikueshme shkencore, në bashkëpunimin me ndërmarrjet inxhinierike dhe industriale si dhe me institucionet shtetërore dhe publike. Stafi akademik në Fakultetin tonë posedon kualifikimet më të larta për të gjitha format e punës akademike dhe shkencore.

Studimet në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike organizohen në nivelin Bachelor dhe Master në 6 programe mësimore:

- **Prodhimtari dhe Automatizim,**
- **Termoenergjetikë dhe Energji e ripërtrishme,**
- **Konstruksione dhe mekanizim,**
- **Komunikacion,**
- **Mekatronikë,**
- **Inxhinieri Industriale dhe Menaxhment.**

Mësimi realizohet në formë të ligjëratave, ushtrimeve numerike, ushtrimeve laboratorike, vizitave mësimore në terren, hulumtimeve, seminareve, etj.

Fakulteti posedon salla të mësimit të standardeve të larta, salla kompjuterike, laboratorë, bibliotekën moderne, etj.

Të nderuar studentë të ardhshëm, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike është institucion i cili synon zhvillimin dhe rritjen ekonomike të Kosovës.

***Bëhuni pjesë e programet tona dhe na ndihmoni në realizimin e synimit tonë. Mos hezitoni të na kontaktoni, vizitoni dhe të pyetni për çdo gjë që mund të ju interesoj.***



### Programi: **TERMOENERGJETIKË DHE ENERGJI E RIPËRTRITSHME**

Programi studimor i kësaj lëmie shumë aktuale ju mundëson studentëve fillimisht familjarizimin me konceptet themelore nga inxhinieria mekanike, thellimin në fundamentet e Termodinamikës dhe Mekanikës së fluideve, si dhe studimin e parimit të punës, projektimit dhe aplikimit eficient të pajisjeve termoteknike dhe sistemeve për shfrytëzimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë.



Përpos aftësimin dhe përvetësimit të shkathtësive të nevojshme për punë të pavarur dhe ekipe profesionale në lëmin e **Termoenergjetikës dhe Energjisë së ripërtrishme**, studentët gjatë studimeve në nivelin Bachelor fitojnë edhe një bazë solide të njohurive të nevojshme për vazhdimin e studimeve të nivelit Master.

Pas përfundimit të studimeve të nivelit Bachelor ju do të jeni në gjendje të:

- Dalloni pajisjet dhe kuptoni proceset termoenergjetike dhe ato të prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtrishme,
- Të vlerësoni rëndësinë, potencialin dhe dobinë ekonomike të burimeve të ndryshme të energjisë së ripërtrishme (solare, të erës, gjeotermale, të ujit, biomasës) si dhe integrimin e tyre në sistemin e përgjithshëm energjetik,
- Bëni incizimin, shtroni bilansin termik dhe kryeni kalkulimet termike të ndërtesave dhe shpenzuesve tjerë termik,
- Bëni dizajnimin dhe projektimin e sistemeve të ngrohjes, ftohjes, ventilimit dhe klimatizimit,
- Kuptoni natyrën dhe specifikat inxhinierike të shndërrimit të energjisë në sistemet e energjisë së ripërtrishme si dhe të bëni projektimin e sistemeve të tilla.

